



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 442/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mosfunksionimit të sprejt dhe të baterive fluoreshente, në seancën e panelit të mbajtur me 31.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se gjate ditës se zgjedhjeve dt, 12.12.2010 nuk ka funksionuar sprejt dhe bateritë fluoreshente në Qendrat e Votimit (QV) në Mitrovicë: Shkolla fillore “Migjeni” – Ilirida; Shkolla fillore “Abdullah Shabani” – Ilirida; Shkolla fillore “Fazli Grajqevci” – Shipol; Shkolla fillore “Shaban Idrizi” – Zhabar; Shkolla fillore “Skënderbeu” – Vaganicë; Rruga “Sami Frashëri” 57 lagjja e Boshnjakëve; Shkolla Fillore “Aziz Sylejmani” – Kodra e Minatorëve; Shkolla fillore “Anton Zako Çajupi” – Qendër; Shkolla fillore “Bedri Gjinaj” – Sitnicë; Shkolla fillore “Hivzi Sylejmani” – Kqiq; Shkolla fillore “Bajram Curri” – Gushavcë; Shkolla fillore “Bajram Curri” – Vidimirç; Shkolla fillore “Minatorët” – Rahovë; Shkolla fillore “Trepça” Mazhiq; Shkolla fillore “Mehë Uka” – Bajgorë; Shkolla fillore “Jusuf Rexha” – Koshtovë; Shkolla “Bujqësore” – Lagja e Romëve; Shkolla fillore “Bislim Hajdari” – Kaqandoll; Shkolla fillore “Habib Jusufi” – Vllahi; Shkolla fillore “Rifat Vidishiçi” – Bare; Shkolla fillore “Elena Gjika” – Tuneli i parë; Shkolla fillore “1 Maji” – Shupkofcë; Shkolla fillore “Sefedin Smakaj” – Rshanë; Shkolla fillore “Fazli Grajqevci” – Vërbnicë dhe shkolla fillore “Trepça” – Melenicë. Parashtruesi i ankesës konsideron se është shkelur neni 7 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore nr. 09/2009, prandaj kërkon nga PZAP-i që te marri masa ndëshkuese.

PZAP-i, në kuptim 118.4 të LZP-së, i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të theksuara në Aktgjykimin A.A.136/2010 të datës 29.12.2010, e pas vlerësimit të gjithë anshëm të shkresave të lëndës, gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Me rastin e shqyrtimit te ankesës paneli gjeti se ankesa është e pabazuar për faktin se mosfunksionimi eventual i llampave fluoreshente ne momente te para të fillimit të votimit assesi nuk është fakt i cili me siguri mund të ndikoj në rezultatet finale, andaj për këtë arsye paneli ka gjetur jo të domosdoshëm përsëritjen e votimit në qendrat e votimit të përfshira në ankesë. Se llampat kontestuese nuk kanë funksionuar vetëm ne fillim te votimit është raportuar edhe nga mediat e ndryshme vendore, kurse ne asnjë mënyrë nuk është raportuar se këto llampa nuk kanë funksionuar gjatë gjithë ditës së votimit. Po ashtu përmes mediave është informuar opinionin se kompetentet kanë intervenuar shumë shpejt duke ndërruar bateritë e këtyre llampave dhe procesi i votimit është zhvilluar normalisht. Meqë me asnjë dëshmi nuk është vërtetuar se këto llampa nuk kanë funksionuar gjatë gjithë procesit të votimit, rezulton fakti i pamohueshëm se defektet në llampa kontestuese kanë qenë vetëm në fillim të votimit. Është e vërtet se edhe për një moment të caktuar mosfunksionimi i llampave fluoreshente me rastin e votimit paraqet shkelje të rregullave të votimit e paraparë më LZP-ë, mirëpo kjo shkelje si në rastin konkret në asnjë mënyrë nuk paraqet shkelje serioze të procesit zgjedhor dhe si e tillë nuk mund ta dëmtoj procesin e votimit aq sa për tu anuluar i njëjti proces, pasi që është fakt notorë se votuesi me rastin e votimit identifikohet edhe nëpërmes letërnjoftimit dhe më atë rast në atë vendvotim nuk mund të votoj dy herë e më tepër i njëjti person, ndërkaq nëse gjithnjë supozojmë se nuk i janë identifikuar gishtat me llampën fluoreshente i njëjti person mund të votoj me kusht në ndonjë vendvotim tjetër mirëpo ai votim me rastin e numërimit patjetër që do të anulohet meqë sistemi i regjistrimit të votave përmes kompjuterit automatikisht identifikon votuesin me emër e mbiemër nëse ka votuar një herë më parë në ndonjë vendvotim tjetër. Andaj janë këto arsye reale për shkak të të cilave nuk mund të anulohet votimi plotësisht në një vendvotim apo qendër votimi nëse llampat fluoreshente nuk kanë funksionuar momentet e para te fillimit të votimit. Nëse në rastin me të keq llampat fluoreshente nuk do të kishin funksionuar fare apo për një kohë të gjatë, gjatë kohës së votimit atëherë vërtet ndoshta do të ketë mundësi që procesi i votimit të dëmtohet për faktin se numri i votave me kusht në atë rast do të ishte tepër i madh për shkak të mundësisë së keqpërdorimit të se drejtës së votimit vetëm një herë, të cilin fakt pa tjetër do ta kishin evidentuar edhe KKZ dhe KQZ-ja mirëpo dukuritë e tilla është fakt notorë se këto institucione nuk i kanë vërejtur e as identifikuar.

Për këto arsye të cekura me lartë PZAP-i vlerëson se mosfunksionimi i llampave në momentet e para të fillimit të votimit në qendrat e votimit, përkatësisht vendvotimet e përfshira në ankesë nuk paraqet situatë të jashtëzakonshme dhe as që mund të ndikoj fare në rezultatet finale të votimit, kushte këto të cilat kërkohen për anulimin e rezultateve të votimit në kuptim të nenit 120.1 nën b. Të LZP-së.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .

PZAP –i për arsyet e lartpërmendura gjen se ankesa e paraqitur është e pabazuar, andaj edhe vendosi si ne dispozitiv ne kuptim te nenit 118.1 dhe pike 2 te LZP, si dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe procedurave te PZAP-it te dt.17 nëntor 2010.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë*

është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa

A nr. 442/2010 më datën 31.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

